

20262123307

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

ПËР NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 27/18, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23, 193/24, 75/25, 154/25, 269/25 dhe 62/26), neni 156 ndryshohet si vijon:

„(1) Me Fondin menaxhon Bordi Drejtues.

(2) Bordi Drejtues ka shtatë anëtarë të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një periudhë prej pesë vitesh. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, pesë anëtarë emërohen me propozim të:

- Ministritë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, një përfaqësues,
- Ministritë së Financave, një përfaqësues,
- sindikates përfaqësuese anëtare e Këshillit Ekonomik Social, një përfaqësues,
- shokatës përfaqësuese të punëdhënësve anëtare e Këshillit Ekonomik Social, një përfaqësues dhe

- Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, një përfaqësues.

(3) Bordi Drejtues nga radhët e veta zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin për një periudhë prej një viti.

(4) Anëtar i Bordit Drejtues mund të emërohet personi që plotëson kushtet për emërim të përcaktuara me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(5) Anëtari i Bordit Drejtues emërohet në procedurë të përcaktuar në përputhje me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(6) Bordi Drejtues i Fondit, të paktën një herë në vit, i paraqet raport për punën e tij për miratim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.“.

Neni 2

Neni 158 ndryshohet si vijon:

„(1) Anëtarit të Bordit Drejtues mandati i ndërpritet me skadimin e mandatit, ndërsa para skadimit të mandatit shkarkohet dhe mandati i ndërpritet sipas fuqisë ligjore në pajtim me Ligjin e Udhëheqësve të Lartë.

(2) Përveç rasteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, anëtari i Bordit Drejtues mund të shkarkohet edhe nëse:

- 1) mungon pa arsye nga seancat e Bordit Drejtues së paku dy herë radhazi;
- 2) i ka pushuar baza mbi të cilën është propozuar;
- 3) në mënyrë shtesë vërtetohet se ka interes personal, interes përmes personit të tretë ose interes mbi çfarëdo baze tjetër, i cili mund të ndikojë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.“.

Neni 3

Neni 159 ndryshohet si vijon:

„(1) Fondi ka drejtor dhe zëvendësdrejtor të cilët i emëron Bordi Drejtues.

(2) Për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit zhvillohet procedurë në përputhje me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(3) Për drejtor, gjegjësisht zëvendësdrejtor të Fondit mund të emërohet personi që plotëson kushtet për emërim të përcaktuara me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(4) Pëlqim për vendimin për emërimin e drejtorit, gjegjësisht zëvendësdrejtorit të Fondit jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Pas emërimit të drejtorit, gjegjësisht zëvendësdrejtorit të Fondit lidhet mevdorë (kontratë menaxheriale) midis drejtorit të emëruar, gjegjësisht zëvendësdrejtorit dhe Bordit Drejtues.

(6) Mandati i drejtorit, gjegjësisht zëvendësdrejtorit zgjat pesë vjet.

(7) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (6) i këtij neni, i njëjti person mund të emërohet sërish për drejtor, gjegjësisht zëvendësdrejtor.

(8) Drejtori e përfaqëson dhe e prezanton Fondin.“.

Neni 4

Neni 160 fshihet.

Neni 5

Neni 162 ndryshohet si vijon:

„(1) Drejtorit, përkatësisht zëvendësdrejtorit të Fondit mandati i ndërpritet me skadimin e mandatit, ndërsa para skadimit të mandatit shkarkohet dhe mandati i ndërpritet sipas fuqisë ligjore në përputhje me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(2) Përveç rasteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, drejtori, përkatësisht zëvendësdrejtori i Fondit mund të shkarkohet edhe nëse:

1) pengon ose në mënyrë tjetër pamundëson realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të shfrytëzuesve të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe

2) në afat prej dy tremujorëve të njëpasnjëshëm Fondi tregon rezultate negative financiare në punë.

(3) Drejtori, përkatësisht zëvendësdrejtori i Fondit mund të shkarkohet edhe me propozim të ministrit të politikës sociale, demografisë dhe të rinjve, në rastet sipas paragrafit (2) të këtij neni, gjatë kryerjes së të drejtës së mbikëqyrjes.“.

Neni 6

Në nenin 162-a në paragrafin (1) fjalët: „pas konkursit të shpallur publik, por jo më gjatë se gjashtë muaj“ zëvendësohen me fjalët: „në përputhje me procedurën e përcaktuar me Ligjin e Udhëheqësve të Lartë, por jo për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj“.

Neni 7

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Fondit të emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdojnë të kryejnë funksionin deri në kalimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq do të fillojë të zbatohet nga 1 tetori i vitit 2026.